

## **Procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim**

- 1.** Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji.
- 2.** Në çdo rast, kërkesa për informim regjistrohet dhe për të caktohet një numër rendor. Numri rendor, së bashku me të dhënat e kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit, i jepet kërkuarit që ka bërë kërkesën për informim.
- 3.** Kërkesat për informim regjistrohen sipas radhës së paraqitjes dhe trajtohen pa dallime mes tyre.
- 4.** Kërkesa për informim duhet të përmbajë:
  - a)** emrin dhe mbiemrin e kërkuarit;
  - b)** adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
  - c)** përshkrimin e informacionit që kërkohet;
  - ç)** formatin në të cilin preferohet informacioni;
  - d)** çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.
- 5.** Në qoftë se kërkesa për informim nuk e përcakton formatin në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.